

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR KOSOVA OIL SH.P.K.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA, VULA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI, THEMELUESIT

1.1 Sot, më datë 04.04.2022,

Z.Sazan Ismaili, atësia Musa, lindur më 29.04.1988, në Mamëz, Kukës, Shqipëri, banues në Tiranë, identifikuar me ID I80429094P;

Z.Bledar Skenderi, atësia Sami, lindur më 12.08.1978, në Frashër, Shqipëri, banues në Tiranë, identifikuar me ID H80812117M;

Z.Jonis Ferati, atësia Esat, lindur më 25.04.1986, në Kullas, banues në Tiranë, identifikuar me ID I60425075K,

krijojnë shoqërinë KOSOVA OIL sh.p.k.

1.2 **KOSOVA OIL sh.p.k. është shoqëri tregtare private me përgjegjësi të kufizuar, e cila këtu e më poshtë do të quhet Shoqëria.**

NENI 2

FORMA DHE VULA E SHOQERISE

2.1 Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 3

BAZA JURIDIKE

3.1 Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4

SELIA

4.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Fushe-Preze, Vorë, Tiranë, numër pasurie 150/10/ND, Zona Kadastrale Nr.3049.

NENI 5

TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale), zyrë ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

6.1 Ushtrimin e veprimtarisë në fushën: Tregti me pakicë e të gjitha llojeve të karburanteve, gazit e nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikante, bar-kafe, fast food, tregti me pakicë e artikujve ushqimorë dhe industriale, servis automjeteve, gomisteri, lavazh, qiradhenie, transport mallrash për nevojat e tij etj.

NENI 7

KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve.

KREU II

KAPITALI

NENI 8

KAPITALI THEMELTAR

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100(njeqind) lekë.

8.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është kontribut i ortakëve themelues, i ndarë në 3 (tre) kuota.

8.3 Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakëve.

NENI 9

KONTRIBUTET

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve në vlerën 100 (njeqind) lekë.

NENI 10

PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

10.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 3 pjesë plotësisht të shlyera.

- Z.Sazan Ismaili, zoterues i 1 (nje) kuote që përfaqëson 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Z.Bledar Skenderi, zoterues i 1 (nje) kuote që përfaqëson 33.33% të kapitalit themeltar të

shoqërise.

- Z.Jonis Ferati, zoterues i 1 (nje) kuote qe perfaqeson 33.33% te kapitalit themeltar te shoqërise.

NENI 11

LËNIA DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

11.1 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortakët vendosin për këtë.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen dhe kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqërise
- b) Shitblerjes
- c) Trashgimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

11.2 Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, perderisa nuk parashikohet ndryshe ne kete statut. Gjithashtu kapitali themeltar është i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkëshortja, parardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, me vendim të Asamblese se Ortakeve dhe sipas kushteve që lejohen me ligj.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 12

ORTAKËT

12.1 Ortakët ushtrojnë të gjitha kompetencat që i njihen me ligj për shkak të kësaj cilësie.

NENI 13

FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

13.1 Fusha e autoritetit të ortakeve dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzojnë ortakët në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të paracaktuara në këtë statut.

NENI 14

KOMPETENCAT E ORTAKËVE

14.1 Për sa kohë që Shoqëria do të përbëhet nga tre ortake kompetencat e tyre do të jenë:

- Percaktimin me politikave tregtare te shoqërise.

- Vendosin për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilojnë ose miratojnë rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçantë të veprimtarisë.
- Vendosin për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit dhe transferimin e pjesëve të kapitalit.
- Vendosin për politikën afariste të Shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emërojnë dhe shkarkojnë admindistratorët e Shoqërisë dhe detajojnë kompetencat e tyre të përcaktuara në statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabël.
- Shqyrtojnë bilancin vjetor, përcaktojnë llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendosin për marrjen e kredive.
- Vendosin për krijimin e degëve (filialeve) ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizike apo juridikë.
- Vendosin për marrëdhëniet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.
- Vendosin për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.
- Vendosin tarifat e sherbimeve
- Vendosin për pagat e të punësuarve në Shoqëri.
- Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 15

MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

15.1. Asambleja e Përgjithshme është Organi më i lartë vendim-marrës i shoqërisë. Ajo mbledhet në seance të zakonshme të pakten një herë në vit apo sa herë kërkohej në përputhje me Ligjin 9901/2008 "Për Tregtarët e Shoqërite Tregtare", i ndryshuar.

15.2 Administratori ka për detyrë të njoftojë Ortaket për mbajtjen e mbledhjes së Asamblese me shkrim nepermjet postës së regjistruar të pakten 7 ditë përpara organizimit ose nepermjet postës elektronike, ku duhet të përfshijë:

- Rëndin e ditës për të cilin do të diskutohet
- Kohën (datën, orën)
- Vendin e mbajtjes së mbledhjes

15.3 Për efekt vlefshmerie dërgimi i njoftimeve për mbledhjen e Asamblese dhe marrja e tyre në dorezim nga ortaket duhet të pasqyrohen në librat e protokollit të shoqërisë ose/dhe të arkivohen të shoqëruara me mandatet postare përkatëse.

15.4 Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas procedures se mesiperme, ajo mund te marre vendime te vlefshme, nese te gjithe ortaket jane dakord per te marre vendime.

NENI 16

KUORUMI

16.1 Per marrjen e vendimeve ne mbledhjet e Asamblese qe kerkojne shumice te cilesuar, kerkohet nje kurum prej 50% te numrit te pergjithshem te ortakeve present.

16.2 Per ceshtje te tjera te parashikuara ne ligj, Asambleja e ortakve vendos me shumicen e thjeshte te votave, kur kuorumi minimal i pjesmarrjes eshte 30%.

16.3 Kur Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet perseri per shkak te mungeses se kuorunit te percaktuar me lart, asambleja mblidhet perseri 30 diteve me te njejtin rend dite.

NENI 17

MARRJA E VENDIMEVE

17.1 Asambleja e Pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te zoteruesit te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

17.2 Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera si:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Emerimin dhe shkarkimin e administratore
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- Percaktimin e shperblimeve
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore te shoqerise dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Perfaqesim te shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratoreve.
- Cdo ndryshim ne Statut duhet te dorezohet prane QKB-se, per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 18

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

18.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes, nese Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- Vleresimin e veprimtarise se tij
- Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij

- Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
- Dhenien ose jo te perfitimeve te reja

18.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 19

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

19.1 Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose disa persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte, pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit.

19.2 Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita, eshte i pavlefshem.

19.3 Administratori i Shoqërisë është Znj.Erikejda Tafa, i bija e Kujtim-it, lindur më 09.10.1997, lindur në Kucovë, Shqipëri, nr. ID.J76009052J, adresa, Rr.Jordan Misja, Tiranë. Ai ushtron këtë detyrë për një periudhe 5 vjet.

19.4 Nese asambleja emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne se bashku shoqerine.

19.5 Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marrredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.


19.6 Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje me shumice te zakonshme administratorin ne cdo kohe.

NENI 20

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

20.1 Kompetencat e administratorit ose të administratorëve, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme. Ne raste te vecanta Administratori mund te autorizojte me prokure te posacme, konform dispozitave perkatese te Kodit Civil, nje person te trete te perfaqesoje shoqerine.
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare.
- Realizon administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e Shoqërisë në marrëdhëniet me persona të tjerë juridikë apo fizikë.



- Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur, per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen dhe ekzistencen e shoqerise.
- Kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut
- Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:
 - Sipas bilancit vjetor apo raportimeve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise, nuk mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve.
 - Shoqeria propozon te shese apo disponoje ne menyre tjeter aktive, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - Shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.
- Shqyrton ofertat dhe pergatit kerkesa te cilat ia paraqet Asambleja e Ortakeve per miratim.
- Ndjek problemet e Shoqerise ne marrredhene me organet shtetore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Ortakeve te Shoqerise cmimet e mallrave, si dhe per pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.
- I propozon Ortakeve rregulloret per sektorë te veçantë të Shoqerise.

NENI 21

PERGJEGJESITET E ADMINISTRATORIT

21.1 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

21.2 Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë apo të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

21.3 Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut, ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante, ndikimit te vemprimtarise se shoqerise ne mjedis.

21.4 Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve qe pershkruhen ne keto dispozita.

- 21.5 Te vleresoje me pergjegjesi ceshjtjet, per te cilat merret vendim
- 21.6 Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale apo te shoqerise.
- 21.7 Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e duhur.
- 21.8 Administratori, gjate kryerjes se detyres se tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- 21.9 Nese administratori, vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim personal, qe ai apo personat e lidhur me te, kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij sipas rregullave dhe standarteve te kerkuara.
- Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen perpara shoqerise ne menyre solidatre.
- 21.10 Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit 'Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare', kryen veprimet e meposhtme:
- U kthen ortakeve kontributet
 - U paguan ortakeve interesa apo dividente
 - U shperndan aktivet e shoqerise
 - Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk kishet aftesi paguese per te shlyer detyrimet
 - Jep kredi
- 21.11 Pervec padise per shlyerjen e demit, qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrejne padi penale ndaj administratorit.
- 21.12 Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e padise kunder administratorit, per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET-DIVIDENTET

NENI 22

VITI FINANCIAR, BILANCI

Three blue ink signatures are present at the bottom of the page, corresponding to the title 'VITI FINANCIAR, BILANCI'. The signatures are stylized and written in a cursive hand.

22.1 Viti financiar fillon në 1 janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

22.2 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionete vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortakët. Miratimi i dokumentave mbi veprimatrinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 23

EKSPERTET

23.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacion kontabel të veprimtarisë ekonomike-tregtare të shoqërisë, atë të gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e ortakëve.

23.2 Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar, përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit vjetor si dhe për atë të kontrolleve periodike të ushtruara, të cilat i detyruar t'ia paraqesë në kohë ortakëve të shoqërisë, për t'i shqyrtuar e miratuar në bazë të së drejtës vendimore që kanë.

NENI 24

DIVIDENTET

24.1 Ortakët miratojnë llogaritë vjetore dhe evidentojnë ekzistencën e fitimit. Ata përcaktojnë fitimin e vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna menjandë për: rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga verë ortaku, fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparëshme. Kështu ortakët përcaktojnë dhe dividendin.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISE-TE TJERA

NENI 25


MBARIMI

25.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakëve ose kur ka një prishje të parakohshme për arsytet e parashikuara në ligj.

NENI 26

LIKUJDIMI

26.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortakët caktojnë një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin atyre raportin mbi gjendjen e aktivitetit



dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit, ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Mbas pagimit të kreditorëve ortakët mbajnë pjesën e mbetur të kapitalit.

NENI 27

KONFIDENCIALITETI

27.1 Ortaket, si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 28

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

28.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

NENI 29

DISPOZITA E FUNDIT

29.1 Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, vlejnë dispozitat e Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.
Tirane, me 16.03.2022.

ORTAKET


Sazan ISMAILI

Sazan ISMAILI



Bledar SKENDERI

Bledar



Jonis FERATI

Jonis Ferati

